



KUMTESË PËR SHYTP

KUMTESË PËR SHYTP

KUMTESË PËR SHYTP

REAGIM:**PO PËRKEQËSOHET AMBIENTI PËR TË BËRË BIZNES NË KOSOVË**

Raporti i fundit i Bankës Botërore, i publikuar një ditë më parë, nuk paraqet pasqyrë të mirë sa i përket ambientit për të bërë biznes në Kosovë. "Të bësh biznes 2011" (Doing Business 2011) rangon Kosovën në vendin e 119 nga 183 shtete ku bëhen këto matje. Në krahasim me një vit më parë, Kosova ka shënuar më keq për gjashtë vende, nga vendi i 113 që ishte ranguar një vit më parë.¹

Me rastin e publikimit të raportit të vitit të kaluar, GAP ka kërkuar që Qeveria e Kosovës të marrë masa në përmirësimin e indikatorëve të përmendur në raportin e Bankës Botërore. Megjithatë, Qeveria e Kosovës nuk ka marrë masa të tilla për përmirësimin e ambientit të biznesit në vend. Vendimi i vetëm dhe i vonuar i Qeverisë së Kosovës është ai i datës 29 shtator 2010, kur është formuar Grupi Ndërmintor për Reformimin e Ambientit të Biznesit. Mirëpo, ky grup nuk ka arritë që të mbledhet asnjëherë për shkak të krizës qeveritare.

Në publikimin e shoqërisë civile "Raporti i Progresit – Made in Kosova", i publikuar më 25 tetor 2010, kemi konstatuar se Kosova ka shënuar regres sa i përket zhvillimit ekonomik dhe ambientit të biznesit. Në këtë publikim, kemi ngritur shqetësimin se arkat fiskale nuk janë shpërndarë konform rregullave të një ekonomie të tregut të lirë, çka ka dëmtuar bizneset në masë të madhe. E njëjta thuhet edhe në "Të Bërit Biznes 2011", ku konstatohet se marrja e numrit fiskal ka ndikuar në ngadalësimin e rritjes së bizneseve dhe ka zgjatur kohën për marrjen e lejes për bizneset e reja, kjo për shkak të procedurave të komplikuara administrative.

Institucionet qeveritare duhet të marrin masa për reformimin e ambientit të biznesit në vend, me qëllim që raporti i ardhshëm i Bankës Botërore të mos gjej Kosovën në vendin e njëjtë apo të shënoj regres, siç ka ndodhur në tri vitet e fundit, prej kur kjo organizatë ka përfshirë edhe Kosovën në matjet e kësaj natyre.

Instituti për Studime të Avancuara GAP**4 nëntor 2010****Prishtinë**

¹ Në raportin "Doing Business 2011", është përvjedhur një gabim, ngase në këtë raport thuhet se Kosova në 2010 është ranguar e 118, kurse në raportin e kaluar Kosova ka qenë në vendin e 113. Këto dallime në shifra vërehen në disa vende të raportit "Doing Business 2011". Rënia reale është për 6 vende dhe jo për një vend.

Annex: Krahasimi i indikatorëve të "Doing Business 2011" për vitet 2010 dhe 2011.

	2010	2011
Lehtësia e të bërit biznes (renditja)	113	119
Themelimi i biznesit (renditja)	164	163
Procedurat (numri)	9	10
Koha (ditë)	52	58
Kostoja (si % e të hyrave për kokë banori)	43.3	28.7
Kapitali minimal (si % e të hyrave për kokë banori)	169.5	112.4
Marrja e lejeve për ndërtim (renditja)	176	173
Procedurat (numri)	21	21
Koha (ditë)	320	320
Kostoja (si % e të hyrave për kokë banori)	1291	856.5
Punësimi i puntorëve (renditja)	34	n/a
Indeksi i vështirësisë së marrjes së puntorëve (0-100)	0	n/a
Indeksi i rreptësisë së orëve të punës (0-100)	0	n/a
Indeksi i vështirësisë së përsëritjes (0-100)	30	n/a
Indeksi i rreptësisë në punësim (0-100)	10	n/a
Kostoja e përsëritjes (javë të pagës)	30	n/a
Regjistrimi i pronës (renditja)	68	65
Procedurat (numri)	8	8
Koha (ditë)	33	33
Kostoja (si % e të hyrave për kokë banori)	1	0.6
Marrja e Kredisë (renditja)	43	32
Indeksi i fuqisë së të drejtave ligjore (0-10)	8	8
Indeksi i thellësisë së informatava kreditore (0-6)	3	4
Mbulesa e regjistrimit public (si % e të rriturve)	18.9	16.9
Mbulesa e sektorit privat (si % të rriturve)	0	0
Mbrojtja e Investitorëve (renditja)	172	173
Indeksi i shkallës së zbulimit (0-10)	3	3
Indeksi i shtrirjes së përgjegjësisë së drejtorit (0-10)	2	2
Indeksi i lehtësisë së padive aksionare (0-10)	3	3
Indeksi i forcës për mbrojtjen e investitorëve (0-10)	27	2.7
Pagimi i taksave (renditja)	50	41
Pagesat (numri në vit)	33	33
Koha (orë për vit)	163	163
Shkalla e përgjithshme e tatimit (si % e profitit)	28.3	16.5



Tregtia ndërkufitare (renditja)	132	130
Dokumentet e nevojshme për eksport (numri)	8	8
Koha për eksport (ditë)	17	17
Kostoja për eksport (US\$ për kontenjer)	2,270	2,230
Dokumentet e nevojshme për import (numri)	8	8
Koha për import (ditë)	16	16
Kostoja për import (US\$ për kontenjer)	2,330	2,280
Zbatimi i kontratave (renditja)	157	155
Procedurat (numri)	53	53
Koha (ditë)	420	420
Kostoja (si % e kërkesës)	61.2	61.2
Mbyllja e biznesit (renditja)	28	31
Koha (ditë)	2	2
Kostoja (si % e kërkesës)	15	15
Shkalla e rikuperimit (cent për çdo dollarë)	56.8	57.4